



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË

NOTER JETMIRA VERAJ
ADRESA Lagje PAVARËSIA, Blv.
ISMAIL QEMALI, Nd.88, N. 2, kati 2
TEL: 00355683317331

VERTETIM NENSHKRIMI


(STATUTI)

Nr. repertori: 1353

Vlore më 01/10/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2022064210062353416



V2022064210062353416

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
AGROTURIZËM EPIR SHPK

NENI 1 - EMËRTIMI SHOQËRISË

Prej shtetasit shqiptar:

ANILA VEIZAJ, lindur në Vranisht, Vlorë më 13.10.1980 dhe banuese në Brataj – Vlorë Nd.046, H.004, Ap.046; është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur AGROTURIZËM EPIR shpk.

NENI 2 - QENDRA E SHOQËRISË

Shoqëria AGROTURIZËM EPIR SHPK do të ketë qendrën në adresën: Brataj - Selenicë – Vlorë, pasuria Nr.444/1, Zona Kadastrale 1265 dhe do të ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të krijojë agjensi, zyra përfaqesimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 LEKË (njëqindmijë lekë) dhe është tërësisht kapital financiar i ortakut themelues.

Ortaku i vetëm është zotërues i një kuote me vlerë 100.000 LEKE (njëqindmijë lekë). Me vendim të ortakut të vetëm kapitali i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet në mënyrat e parashikuara nga ligji Nr.9901 datë 14.04.2008.

NENI 4 - KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë prej 20 vjetësh.

Ajo do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare që nga data e regjistrimit të saj dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj deri më 01.10.2042.

Shoqëria mund të shkrihet vetëm me vendim të ortakut të vetëm.


NENI 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do ketë objekt të veprimtarisë së saj aktivitetet vijuese:

5.1. Aktivitet në fushën e agroturizmit dhe agrikulturës:

- bujtinë, restorant-bar-kafe,
- prodhim e tregtim i produkteve Bio
- rritje të shpendëve (pula, rosa, pata etj)

Anila Raza Veizaj



V2022064210062353416

5.2. Aktivitetet tregtare mund të kryhen direkt apo në formën e përfaqësive, si në Shqipëri dhe jashtë saj, përfshirë tregtinë me shumicë dhe pakicë. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale, të luajtshme të paluajtshme dhe të kryejë cdo loj aktiviteti tjetër të lejuar që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë. Gjithashtu shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri dhe/ose ndërmarrje të çdo natyre që kanë objekt të njëjtë apo që lidhet me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Shoqëria po ashtu mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera me objekt të njëjtë ose të ndryshëm nga i saj.

NENI 6 - ORGANET DREJTUESE

Administrator i shoqërisë për periudhën e parë 5 vjeçare duke filluar nga data e sotme e deri më 01.10.2027 do jetë ANILA VEIZAJ lindur në Vranisht, Vlorë më 13.10.1980.

Shoqëria AGROTURIZËM EPIR SHPK do të jetë subjekt i te drejtës shqiptare dhe do të ushtroje aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe me normat e aktit themelues dhe të statutit bashkëngjitur.

Ky akt themelimi nënshkruhet prej ortakut themelues në datë 01.10.2022.

ORTAKU THEMELUES / Anila Perzi Veizaj

Vlorë, më 1 tetor 2022 (dymijë e njëzet e dy)



STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
AGROTURIZËM EPIR SHPK

EMËRTIMI-OBJEKTI-QËNDRA-KOHËZGJATJA

NENI 1 – Emërtimi i shoqërisë

Prej shtetasit shqiptar:

ANILA VEIZAJ, lindur në Vranisht, Vlorë më 13.10.1980 dhe banuese në Brataj – Vlorë Nd.046, H.004, Ap.046; është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur AGROTURIZËM EPIR shpk.

Shoqëria do ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare».

NENI 2 – Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Shoqëria do ketë objekt të veprimtarisë së saj aktivitetet vijuese:

2.1. Aktivitet në fushën e agroturizmit dhe agrikulturës:

- bujtinë, restorant-bar-kafe,
- prodhim e tregtim i produkteve Bio
- rritje të shpendëve (pula, rosa, pata etj)

2.2. Aktivitetet tregtare mund të kryhen direkt apo në formën e përfaqësive, si në Shqipëri dhe jashtë saj, përfshirë tregtinë me shumicë dhe pakicë. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale, të luajtshme të paluajtshme dhe të kryejë çdo loj aktiviteti tjetër të lejuar që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë. Gjithashtu shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri dhe/ose ndërmarrje të çdo natyre që kanë objekt të njëjtë apo që lidhet me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Shoqëria po ashtu mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera me objekt të njëjtë ose të ndryshëm nga i saj.

NENI 3 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë prej 20 vjetësh.

Ajo do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare që nga data e regjistrimit të saj dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj deri më 01.10.2042.

Shoqëria mund të shkrihet vetëm me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 4 – Selia e shoqërisë

Shoqëria AGROTURIZËM EPIR SHPK do të ketë qendrën në adresën: Brataj –

Anila Pop Veizaj



V2022064210062353416

Selenicë – Vlorë, pasuria Nr.444/1, Zona Kadastrale 1265 dhe do të ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqëria mund të krijojë agjensi, zyra përfaqesimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 5 - Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 LEKË (njëqindmijë lekë) dhe është tërësisht kapital financiar i ortakut themelues.

Ortaku i vetëm është zotërues i një kuote me vlerë 100.000 LEKE (njëqindmijë lekë). Me vendim të ortakut të vetëm kapitali i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet në mënyrat e parashikuara nga ligji Nr.9901 datë 14.04.2008.

NENI 6 – Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme me vendim të ortakut të vetëm ose në rrugë trashëgimie.

NENI 7 – Ortaku i vetëm

Shoqëria zotërohet nga një ortak dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakut i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investimet e reja;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

NENI 8 – Drejtimi dhe administrimi

8.1. Shoqëria tregtare AGROTURIZËM EPIR shpk do drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim të ortakut të vetëm.

Administrator i Shoqërisë për periudhën e parë 5 vjeçare duke filluar nga data e sotme deri më 01.10.2027 do jetë ANILA VEIZAJ lindur në Vranisht, Vlorë, më 13.10.1980.

8.2. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortakut i vetëm;
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e

Anila Veizaj



V2022064210062353416

ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;

d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raporton përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

8.3. Ortaku i vetëm mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

8.4. Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 „Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të administratorëve të cilat do ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do ishte dhënë.

Administratorët mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosin administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

8.5. Administratori do shpërblehet sipas përcaktimit të ortakut të vetëm në përputhje me parashikimin e nenit 97 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008.

NENI 9 – Kontrolli i brendshëm

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një ekspert kontabël të autorizuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

NENI 10 – Bilanci dhe te ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti përveç rasteve e urdhërave të vecanta të ortakut të vetëm të saj. Në fund të çdo periudhë ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas pagimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim ortakut të vetëm të saj.

NENI 11 – Shpërbërja e shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Në rast

Anila Rexhepi
55



shkrijë para afatit të shoqërisë, Ortaku i vetëm vendos mbi mënyrat e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë duke iu përcaktuar edhe detyrat.
Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi: SHOQËRI NË LIKUIDIM E SIPËR.

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

NENI 12 – Dispozita përfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësimeve të bëra nga ORTAKU I VETËM.

Shoqëria AGROTURIZËM EPIR ShPK do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi, normat e këtij statuti dhe aktit themelues bashkëngjitur.
Ky statut nënshkruhet prej ortakut themelues në datë 01.10.2022.

ORTAKU I VETËM /

Anila Razi Veizaj

Vlorë, më 1 tetor 2022 (dymijë e njëzet e dy)



V2022064210062353416

DATE 01/10/2022

NR/REP 1353

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Në Vlorë sot në datë 1 tetor 2022 (dymijë e njëzet e dy), para meje Noteres JETMIRA Xh. VERAJ, regjistruar në Dhomën e Noterëve Vlorë, në Zyrën time Noteriale në Vlorë – Bulevardi "Ismail Qemali", Kryqëzimi i Kalit te Trojës, Nd.88, H.16, N.2, u paraqit personalisht shtetasja shqiptare:

ANILA VEIZAJ, atësia Razi, amësia Bele, lindur në Vranisht, Vlorë më 13.10.1980 dhe banuese në Brataj - Vlorë Nd.046, H.004, Ap.046; me shtetësi shqiptare; me zotësi të plotë për të vepruar, e panjohur prej meje Noteres, identifikuar me letërnjoftimin Nr.032306089; paraqitur me cilësinë e ortakut themelues të shoqërisë AGROTURIZËM EPIR shpk.

E paraqitura kërkoi prej meje Noteres vërtetimin e nënshkrimit në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë AGROTURIZËM EPIR SHPK pasi nënshkroi në prezencën Time me vullnet te lire.

Unë Noterja verifikova, duke qenë e bindur për identitetin e të paraqiturës dhe përputhjen e aktit noterial të mësipërm me nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr.110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e saj.

Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE JETMIRA Xh. VERAJ

